



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 1548 Prot.

Vlorë më, 13.10. 2021

**VENDIM**  
**Nr. 37, datë 12.10.2021**

**PËR**  
**MIRATIM RIALOKIM KUOTASH NË FAKULTETIN E SHËNDETIT NË**  
**UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË PËR VITIN AKADEMIK 2021- 2022**

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Udhëzimit nr. 11, datë 02.06.2021 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar*" nenit 19, pikal, gërma f, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë si dhe referuar shkresës nr. 1518/1 prot., datë 12.10.2021 të Zëvendësrektorit Akademik, Senati Akademik në mbledhjen e datës 12.10.2021,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shëndetit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë për rialokim kuotash sipas shkresës nr. 1518/1prot., datë 12.10.2021, për rialokimin e 6 kuotave të paplotësuara në programin e studimeve Bachelor në Infermieri e Përgjithshme.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit Akademik, Drejtuesit e Fakultetit të Shëndetit, Kryesekretarit dhe sekretaria mësimore në fakultet.
3. Kuotat e miratuara i përcillen Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. As. Xhiliola AGARAJ**







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**ZV/REKTORI AKADEMIK**

Nr... 1518/1 Prot

Vlorë, më 12 10.2021

Lënda: Përcillet për miratim kërkesa e Fakultetit të Shëndetit për rialokimin e kuotave të pranimit të programit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme

**KRYETARIT TË SENATIT**  
**PROF. DR. ROLAND ZISI**

I nderuar Z. Kryetar,

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 11, datë 02.06.2021 për "Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë" të ndryshuar", Fakulteti i Shëndetit ka kërkuar me shkresën nr. 190/1 Prot, datë 06.10.2021, protokolluar pranë nesh me nr. 1518 Prot, datë 07.10.2021 "Kërkesë për rialokimin e kuotave të programit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme, FSH për vitin akademik 2021-2022", rialokimin e kuotave të programit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme.

Bazuar në shkresën e fakultetit kërkohet rialokimi i kuotave të planifikuara të pranimit të studentëve të ciklit të parë të studimeve për vitin e parë akademik 2021-2022, të cilat nuk kanë patur kandidat, konkretisht 1 kuotë nga trojet, 2 kuota nga kandidatë me statusin e jetimit, 1 kuotë nga kandidatë për shtetas të huaj si dhe 2 kuota nga kandidatë për Romë dhe Ballkano-Egjiptiane, pra 6 kuota të cilat të rialokohen në "Transferime në programin e studimit Infermieri e Përgjithshme".

(Bashkëlidhur shkresa e FSH me nr. 190/1 Prot, datë 06.10.2021, protokolluar pranë nesh me nr. 1518 Prot, datë 07.10.2021)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**ZV/REKTORI AKADEMIK**

**PROF.AS.FROSINA LONDO (QYRDETI)**

Konceptoi: A.Bozhani (Pergj.e Kurrikulave)



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLC

ZYRA E PROTOKOLL - ARKIVËS

NR. 1512 PROT.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DATA 07. 10. 2021

UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE  
FAKULTETI I SHËNDETIT  
DEKANIA

Nr. 180/1 prot.

Vlorë, më 06. 10. 2021

Lënda: Kërkesë për rialokimin e kuotave të programit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme, FSH për vitin akademik 2021-2022.

UNIVERSITETIT 'ISMAIL QEMALI', VLORE

REKTORIT TË UNIVERSITETIT

Prof.Dr.Roland Zisi

I nderuar z.Rektor,

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr 11, datë 02.06.2021 për "Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.10, datë 15.05.2019" Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë" të ndryshuar" bashkangjitur po Ju dërgoj shkresën e Drejtueses së Departamentit të Infermierisë për rialokimin e kuotave.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DEKANIA E FAKULTETIT TË SHËNDETIT

Prof.asoc.Aurela Saliaj

*[Handwritten signature]*







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE**  
**FAKULTETI I SHËNDETIT**  
**DEPARTAMENTI I INFERMIERISË**

Nr. 130 prot.

Vlorë, më 06.10.2021

Lënda: Kërkesë për rialokimin e kuotave të programit Bachelor në Infermieri të përgjithshme për vitin akademik 2021-2022.

**DEKANES SË FAKULTETIT TË SHËNDETIT**  
**Prof.asoc.Aurela Saliaj**

E nderuar znj.Dekane!

Senati Akademik i UV në Vendimin Nr.02, dt.26-01-2021 për "Per miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimit për të gjitha ciklet për vitin akademik 2021-2022" dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr 11, datë 02.06.2021 për "Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr.10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë" të ndryshuar" ka përcaktuar 347 kuota gjithsej për gjithë programet e Departamentit të Infermierisë.

Për rrjedhojë të situatës në përfundim të regjistrimeve të kuotave të jashtme ngelën këto kuota të paplotësuara:

| Programi mësimor                 | Kuota nga trojet | Statusin e jetimit | Shtetas të huaj | Rome dhe Ballkano-Egjiptiane |
|----------------------------------|------------------|--------------------|-----------------|------------------------------|
| Bsc në Infermieri e përgjithshme | 1                | 2                  | 1               | 2                            |

Si procedura të mëtejshme kërkojmë që:

1. Kuotat e mbetura pa plotësuar të riallokohen në ciklin e parë të studimeve:
  - transferime 6 kuota
2. Të përcillet për miratim në Senat riallokimi i kuotave.

**DREJTUESE E DEPARTAMENTIT TË INFERMIERISË**

Dr.Majlinda Zahaj